

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN**, në përbërje prej gjyqtari të vetëm gjykus Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, në çështjen penale ndaj të pandehurit I. A. nga fshati T. K.L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.102/18 të dt.26.02.2018, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësorë publik të mbajtur me dt.25.09.2018, në prezencën e prokurorës të shtetit E. J., e dëmtuara, dhe i pandehuri, në të njëjtën datë, merr dhe publikisht shpall këtë:

## A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

**I. A.**, i biri i S. dhe H., e vajzërisë K., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin T. Komuna L., ku edhe tani jeton, me nr. personal *numri personal...*, shqiptare, shtetase e Republikë së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

**Sepse:**

Me datë 27.12.2017, rreth orës 18:00<sup>h</sup>, në rugën “Komandant Kumanova”, në Lipjan, me saktësisht pronë e objektit të “Viva Fresh-it”, i pandehuri I. A. derisa ishte duke drejtuar automjetin e tipit ‘R. S.’, ngjyrë të kaltër, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, ka shkelur ligjin mbi trafikun piblik, ka vën në rrezik jetën e njerëzve dhe nuk ka pasur kujdesë të shtuar për pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, në atë mënyrë që nga pakujdesia, duke vepruar në kundërshtim me nenin 149 par. 1 të LRRTRR-së, nuk ia ka përshtat mënyrës e lëvizjës kushteve të krijuar në komunikacion, gjatë afrimit të vendkalimit për këmbësorët, nuk i ka kushtuar kujdes të shtuar dhe t’i jepë përparësi këmbësorës-të dëmtuarës J. K., e cila kishte filluar kalimin e rrugës në vendkalimin për këmbësorë dhe si pasojë e këtij lëshimi me pjesën e parë të majtë të automjetit të tij e godet në këmbën e majtë këmbësorën – të dëmtuarën J. K., me ç’rast e njëjta pëson lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin,-

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në baze të neneve, 1, 2, 4, 6, 17, 23, 41, 42, 43, 46, 73, 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-se, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me,

## DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200-€ (dyqindëeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënim me gjobë konform nenit 46 par 3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgimi do t’i llogaritet shuma prej 20-€.

**E dëmtuara:** J. K. nga fshati S. K.L., udhëzohet që kërkesën pasurore- juridike ta realizojnë në procedurë të rregullt civile gjyqësore.

**DETYROHET** i akuzuari në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t’ia paguajë, shumë prej 60.88-€, për paushall gjyqësor shumë prej 20-€, si dhe shumë prej 30.-€, në Fondin e Mbrojtjes së Viktimave, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj, PP.II.nr.102/18 të dt.26.02.2018, e ka akuzuar të pandehurin I. A., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor përfaqësuesi i Prokurorisë ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se pranimi i tillë është i mbështetur në dispozitat ligjore, dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit, si dhe me rastin e matjes së dënimit kësaj gjykate i ka propozuar që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga i pandehuri.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësorë, e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, respektivisht për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe njëkohësisht nga gjykata ka kërkuar që t'i shqiptohet një dënim sa më i butë ngase është hera e parë që ndeshem me ligjin, mbajtëse i familjës, dhe pa të ardhura për çka dënimi i shqiptuar me urdhër ndëshkimor është tepër i lartë dhe nuk kam mundësi ta paguaj, i njëjti gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të pandehurit, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes se llojit të dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese për të pandehurin konform nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi sjelljen e mëparshme të kryerësit të veprës penale pra, për faktin se i njëjti më parë asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin, i pa punë, rrethanat personale dhe familjare ndaj të pandehurit, sjellja e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor i njëjti ka shprehur pendimin, premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen do të jem shumë me i kujdesshëm në komunikacion, ndërsa si rrethan rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të t' pandehuri dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, ashtu që keto vepra penale të rrezikimit të komunikacionit public vetëm janë duke shënuar rritje në kohën e fundit në Kosovë, andaj të njëjtit i shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 200-€, duke u bindur se më këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 41 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u bazua në nenin 450 par. 2 pika 2.1 dhe pika 2.6 të KPPK-së, ashtu që gjykata e detyroi të pandehurin t'ia paguajë kësaj gjykate në emër të shpenzimeve për ekspertizë mjeko-ligjore shumë prej 20-€, për ekspertizë të komunikacionit shumë prej 40.88-€, si dhe në emër të shpenzimeve për paushall gjyqësor shumë prej 20-€, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e Financimit të Kompensimit të Viktimave të Krimit bazohet në nenin 39 par. 3 pika 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ashtu që gjykata e detyroi të pandehurin që në emër të shpenzimeve lidhur me financimin e kompensimit të viktimave të krimit kësaj gjykate t'ia paguaj shumë prej 30-€, të gjitha këto shpenzime në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Vendimin mbi kërkesën pasurore-juridike gjykata e bazoi konform nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN**

**P.nr.147/18 me dt.25.09.2018**

**Sekretarja juridike**

Nexhmije Ahemti

**GJYQTARI**

Avdirrahman Gashi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së të njëjtit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.